

## PËRMBLEDHJA ANALITIKE

Raporti 1 për përparimin e tanishëm të projektit të shfrytëzimit të tokës (ALUP), *EuropeAid/120769/D/SER/KOS, të financuar nga BE përmes Agjencisë Europiane për rindërtim (AER).*

Synimi i përgjithshëm i ALUP-it është ngritja e produktivitetit dhe shfrytëzimi i tokës bujqësore. Projekti përpiqet të arrij këtë duke i definuar 5 komponentet (rezultatet) e projektit, ku secili është i ndërlidhur me (i) kornizën ligjore dhe rregullative, (ii) komasacionin e tokës, (iii) planifikimin hapësinor dhe ambientin, (iv) qasjen në tokë përmes përmirësimit të funksionimit të tregut të tokës dhe (v) mekanizmave më të mirë të koordinimit.

Periudha raportuese është karakterizuar me hapin e ndërmarrë nga plani gjatë fazës fillestare deri në fazën e tanishme implementuese. Është punësuar stafi ndërkombëtar dhe vendor. Më vonë janë kryer misionet e para të ekspertëve ndërkombëtar. Janë bërë marrëveshjet e para me komunat në të cilat do të kryhen pilot aktivitetet.

Në fund të këtij tremujori, AER e ka shprehur dëshirën të fokusohet më tepër në çështjet e pakicave dhe çështjet gjinore, duke e lëshuar një vendim administrativ në këtë kontekst. ALUP i cili do të përkrah këtë prioritet, është i gatshëm të gjej kohë dhe mjete dhe propozoj një punë të përbashkët me AER dhe projektet e AER në vend të një qasjeje individuale të projektit.

Kanë filluar të gjitha pesë rezultatet e projektit. Siç është planifikuar në raportin fillestar, përparim i madh është arritur posaqërisht në rezultatet 1 (korniza rregullative) dhe 2 (komasacioni i tokës), përderisa rezultati 4 ka filluar më së voni në fillim të qershorit, dhe rezultati 3 (planifikimi hapësinor dhe ambienti) gjatë fillimit të korrikut. Rezultati 5 (koordinimi ndërministror) do të filloj që tash. Deri tash përparimi në rezultatin 4.2 (shpërbërja e ndërmarrjes shoqërore Sharr Prodhimi në Dragash) nuk ka qenë i kënaqshëm.

Ngjarjet kryesore kanë qenë pjesëmarrja e ALUP-it në Seminarin Regjional të FAO-s për komasacionin e tokës të mbajtur në Pragë (fund i majit) dhe tubimi me rastin e fillimit të punës së projektit më 26 qershor. Të dy ngjarjet janë vlerësuar si të suksesshme.

Është bërë përpjekje e madhe për të ndihmuar shpalljen e Ligjit për tokën bujqësore përmes shkresave, lidhjeve private dhe në fund përmes vizitës bërë këshilltarit ligjor të UNMIK-ut. Edhe pse ndoshta rastësi, ligji është nënshkruar dy ditë pas vizitës.

Me të madhe është ndier mungesa e buxhetit të vogël që është në dispozicion të projektit për mbulimin e shpenzimeve relativisht të vogla. Gjëja më e rëndësishme ndoshta është mungesa e mjeteve për të mbuluar shpenzimet e komasacionit të tokës në Gjakovë, komasacioni i parë për 20 vitet e fundit, dhe i cili është organizuar nga

ALUP-i. Ky duket të jetë element vendimtar në suksesin apo dështimin e projektit. Shumat e përfolura në të vërtetë nuk janë të mëdha, por të pakapërcyeshme për farmerët jokomercial (vetmbajtës). Shihet qartë se në të ardhmen një përkrahje e tillë materiale duhet të kërkohet nga burime tjera, dhe konsiderohet si e rëndësishme për bujqësinë në Kosovë që kjo përpjekje e parë e komasacionit të tokës në Kosovë të jetë e suksesshme, ALUP-i përpiqet të gjeë burime tjera buxhetore që të mbuloj shpenzimet e transaksionit për këtë komasacion të tokës.

Momentalisht nuk parashihen ndryshime të mëdha në programin e projektit nga ajo që është prezantuar në Raportin fillestar. Akoma nuk kanë mundur të përfshihen ndryshimet e nevojshme për shkak të fokusimit të madh në çështjet gjinore, çështjet e pakicave dhe komunat veriore, sepse ato janë në diskutim e sipër. Megjithatë, kjo mund të ndryshoj në të ardhmen e afërt, varësisht nga madhësia e riorganizimit të programit për shkak të fokusimit të shtuar në pjesën veriore. Në këtë kontekst, propozimet se si të vazhdohet do të dorëzohen ndarazi.

